



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **24.01.2024** të parashtruar nga **RRUGA 07 L.L.C.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja higjenike e objekteve Komunale “ , Nr. i prokurimit- 632-23-14124-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-199-211, nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **“RRUGA 07 L.L.C.**, e dt.24.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja higjenike e objekteve Komunale “ , Nr. i prokurimit- 632-23-14124-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-199-211**, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 21.12.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: 21.12.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y c t i m

Operatori Ekonomik **“RRUGA 07 L.L.C.**, me dt.24.01.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja higjenike e objekteve Komunale “ , Nr. i prokurimit- 632-23-14124-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-199-211.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.01.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pretendimi juaj se me vlerën e parashikuar nuk arrihet të paguhen as pagat e planifikuara për punëtor, nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues, ka konstatuar se është e mjaftueshme vlera e dhënë e parashikuar, por nëse tejkalohej vlera e parashikuar, atëherë Autoriteti Kontraktues do të vepronte sipas ligjit për Prokurim, ku sqarohet qarte çështja e tejkalimit të vlerës së parashikuar. Edhe nëse analizohet mirë analiza financiare e bërë nga ju, vlerat të cilat ju i keni çekur nuk qëndrojnë, sepse pagat bruto për 20 punëtorë arrijnë vlerën mujore 8,000.00€ e jo shifra të cilën ju e keni çekur në kërkesën për rishqyrtim.

2. Ndërsa menaxher për mbikëqyrjen e punës duhet të caktohet njeri nga 20 punëtorët që janë në marrëdhënie pune, prandaj edhe ky pretendim i juaj nuk qëndron.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

